# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-436615**

VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sulm kibernetik në Berlin - “Masakër” të dhënash, 1.4 milionë përfundojnë në ‘Darknet’ |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/-kibernetik-ne-berlin-masaker-te-dhenash-14-milione-perfundojne-ne-dark-i585372` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 11:06:20 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 11:40:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `83a25f9b9afb581981b7a2a97f036008b4016206c9e8bb817172d97840f7243c` |
| TEKSTI | `80995a57402b8eec574c4e34ac9934fbc1c2fe293ed4a9f6c27a457910a7d206` |
| PAMJA | `f3167c5057023899eab23181e13f339eadec05ae0c4090d31779a31e15949ba8` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b926a84b26bc8bfdcda69e149ca942da0c2d0eb6c4d993bae64ca6a3997451ab` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b926a84b26bc8bfdcda69e149ca942da0c2d0eb6c4d993bae64ca6a3997451ab`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Sulm kibernetik në Berlin - “Masakër” të dhënash, 1.4 milionë përfundojnë në ‘Darknet’

11 Shtator 2026, 13:40Bota TEMA

Sulm kibernetik në Berlin - “Masakër” të

Një sulm i rëndë kibernetik ka goditur administratën e Berlinit, vetëm pak ditë përpara zgjedhjeve për Parlamentin e kryeqytetit gjerman.

Rreth 1.4 milionë të dhëna të vjedhura janë publikuar në Darknet, pasi autoritetet refuzuan të paguanin shpërblimin e kërkuar nga hakerët.

Pas sulmit qëndron grupi kriminal kibernetik Rhysida, i cili depërtoi në sistemet e administratave të Ndërtimit dhe Transportit.

Hakerët kërkuan 30 Bitcoin, me vlerë rreth dy milionë euro, duke kërcënuar se në të kundërt do të publikonin materialet. “Berlini nuk do të lejojë të shantazhohet”, deklaroi kryebashkiaku Kai Wegner.

Pas refuzimit të pagesës, në Darknet u publikuan dosje personeli, shkresa zyrtare, fletëpagesa dhe kopje dokumentesh identiteti. Mes informacioneve që mund të jenë komprometuar ka edhe të dhëna për centrale energjetike dhe ngrohjeje, depo karburanti, sisteme të furnizimit emergjent me energji, burgje dhe ujësjellës.

Sipas autoriteteve, hakerët kishin akses në sistemet e administratës nga 7 deri më 14 gusht.

Sulmi dyshohet se nisi pasi një punonjës i Administratës së Transportit ra pre e një emaili “phishing”, duke u hapur pa dashje sulmuesve rrugën drejt rrjetit.

Senati i Berlinit ka ngritur një qendër koordinimi dhe po bashkëpunon me autoritetet federale të sigurisë kibernetike. Autoritetet siguruan ndërkohë se sulmi nuk ka prekur infrastrukturën zgjedhore dhe se votimi për Parlamentin e Berlinit më 20 shtator nuk është në rrezik.

Mes materialeve të vjedhura gjenden ede dokumente për projektin e diskutueshëm të zgjerimit të Kancelarisë Federale, duke e prekur në mënyrë indirekte edhe kancelarin Friedrich Merz.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Republikanët mbyllin Konventën, Vance kandidat në 2028-ën?]

12:10 Bota / 2 komente

[Zelensky konfirmon takimin me Trump në fund të shtatorit: Pas mbledhjes në Nju Jork mund të jem më i hapur për negociatat]

10:05 Bota

[Nga Al-Kaida te "ujqit e vetmuar" dhe IA: Si ndryshoi terrorizmi pas 11 Shtatorit?]

09:55 Bota / 1 koment

[Irani synon të kontrollojë kontaktet me të huajt, projektligji për "infiltrimin" nxjerr në pah përçarjet brenda establishmentit]

09:35 Bota / 1 koment

[Putin mbërrin në New Delhi për samitin e BRICS, në fokus lufta në Ukrainë e Iran dhe tregtia globale]

09:15 Bota

[NATO ndjek anijet ruse në Arktik, dyshime për armë sekrete kundër kabllove nënujore]

09:05 Bota

[Spiunët, strategjitë dhe mundësitë e humbura, analiza: Si po nxirren ende mësimet e 11 shtatorit]

08:45 Bota

["Dilni dhe votoni"/ Trump përsërit premtimin prej 5 mijë dollarësh për zgjedhjet e mesit të mandatit]

08:35 Bota / 3 komente

[11 Shtatori, 25 vjet nga sulmet terroriste në SHBA që ndryshuan botën]

08:05 Bota / 3 komente

[Alarm për kërcënim në konsullatën e Ukrainës në Dyseldorf, policia kontrollon ndërtesën]

07:54 Bota

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**["Berisha gënjeu demokratët" - Bejko: Nuk ka më të drejtën...]**

09:45 Politika / 20 komente

**[Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...]**

15:43 Politika / 29 komente

**EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej “aferën e armëve” m...**

15:30 Dossier / 12 komente

**Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...**

13:04 Politika / 51 komente

**'Kallëzim se po zbatoj ligjin', ministri Malaj publikon p...**

19:05 Politika / 77 komente

## Blog Tema

**Ministrja që Rama po kërkon**

12:40 Blog / 1 koment

**Demokracia, jo më si vlerë lirie**

12:30 Blog

**Një telash më shumë për Partinë Demokratike**

19:10 Blog / 20 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.